



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**"HASAN PRISHTINA"**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor  
Prof. Dr. Marjan DEMA

Nr. Prot.: 2/640  
Datë: 28/9/2018

Në bazë nenit 48, dhe në lidhje me nenin 142,143 dhe 144 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, lidhur mbi transferimin e studentëve në të gjitha njësitë akademike, Senati i Universitetit të Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 10.09.2018, mori këtë:


**V E N D I M**

1. Studenti mund të bëjë ndërrimin e programit të studimit duke përfunduar mësimin në një program të studimit dhe duke filluar mësimin në një program tjetër të studimit në njësinë e njëjtë apo në njësinë tjetër akademike të Universitetit.
2. Ndërrimi i programit të studimit është i mundur në mes programeve të studimit me qëllim të arritjes së nivelit të njëjtë të arsimit në pajtim me dispozitat e këtij Statuti;
3. Gjatë ndërrimit të programit të studimit studentit i lejohet legalisht të fillojë programin e ri të studimit nëse së paku 50% e provimeve janë dhënë me sukses gjatë programit të vjetër të studimeve dhe që pranohen në programin e ri të studimeve.
4. Sipas pikës (3), studentit i lejohet të regjistrohet në programin e ri të studimeve:
  - 4.1. Më së paku në vitin e dytë të studimeve ose;
  - 4.2. Më së mirë në vitin e studimeve që vijon pas programit të vjetër të studimeve.
5. Ndërrimi i programit të studimit nuk mund të bëhet nëse studentit duhet sërish të regjistrohet në vitin e parë të studimeve në programin e ri të studimeve në pajtim me pikën (3) dhe (4).
6. Ndërrimi i programeve mund të lejohet deri në 5% nga grupi i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në vitin akademik paraprak, në degën përkatëse të fakultetit.
7. Në Fakultetin e Mjekësisë ndërrimi i programit të studimeve mund të lejohet vetëm nga viti i tretë i studimeve, deri në 5% nga numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në vitin akademik paraprak, në degën përkatëse të fakultetit, përjashtimisht me lejen e Rektorit në raste të veçanta.
8. Ngjashëm me pikën 2 të këtij vendimi, në të gjitha njësitë akademike lejohet transferimi i studentëve pas përfundimit të vitit të parë të studimeve, përjashtimisht për Fakultetin e Mjekësisë, Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës-Dep.Arkitekturës (programi 5 vjeçar) dhe Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë-Programi Veterinarisë, transferi i studentëve lejohet vetëm nga viti i tretë i studimeve.

9. Studentët të cilët aplikojnë për transfer duhet t'i plotësojnë kushtet për regjistrim të vitit vijues, ngajshëm me studentët e fakultetit përkatës të Universitetit të Prishtinës.
10. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, anulohet vendimi paraprak i cili ka rregulluar çështjen e transferit të studentëve.
11. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen kriteret që rregullojnë këto çështje në pikën III dhe IV të vendimit nr.2/862, dt. 10.10.2017.
12. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senat dhe vlen deri në ndryshim të kushteve me një vendim tjetër.

Vendimi ti dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Dekanëve të Fakulteteve;
3. Sekretarëve të Fakulteteve;
4. Sekretarit të Përgjishëm;
5. Shërbimit të studentëve në AQ.



Prof. dr. Marjan Dema

*Marjan Dema*  
Rektor i UP-së